



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit:23.14.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË STACIONIT TË AUTOBUSËVE SH.A.
PRISHTINË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, korrik 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Stacionit të Autobusëve sh.a Prishtinë, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme *Vlora Spanca*, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Senver Morina dhe Ernes Beka, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Enver Boqolli.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	25
5 Qeverisja.....	26
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	32
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	35
Shtojca III: Letër Konfirmimi.....	38

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Stacionit të Autobusëve sh.a të Prishtinës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 20/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar bazuar në cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Stacionit të Autobusëve.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Stacionit të Autobusëve për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, përveç efekteve të përshkruara në paragrafin Baza për Opinion të kualifikuar, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryesuesi i Bordit është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Stacionit të Autobusëve sh.a. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Stacionit të Autobusëve sh.a se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP-së).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. PFV-të përgatiten dhe nënshkruhen nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshafi Ekzekutiv (KE) dhe dorëzohen për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Stacionit të Autobusëve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë: pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese.

Sipas opinionit tonë përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për bazën për opinion të kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parimit akrual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për opinion të kualifikuar

- Sipas SNK 16, kërkohet që njëherë në 3 deri 5 vite të bëhet rivlerësimi i pasurive jo qarkulluese. Vlera e pasurive jo qarkulluese (toka dhe objekte ndërtimore) sipas PFV ishte 2,549,320€ për të cilat Stacioni i Autobusëve nuk kishte bërë asnjëherë rivlerësimin e tyre. Kjo për shkak të vështirësive financiare për ti mbuluar kostot e rivlerësimit të pasurive.

Çështje Të tjera

Pasqyrat financiare vjetore të Stacionit të Autobusëve për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 janë audituar nga një kompani private e auditimit, e cila kishte dhënë **opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes**, për shkak të mos rivlerësimit të pasurive.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit të Stacionit të Autobusëve është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit aktual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës, si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Stacionit të Autobusëve.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të

auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik (me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe
- Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përgatisë raportet si në vijim:
 - Statuti i NP-së;
 - Plani i Biznesit;
 - Raporte tremujore;
 - Raporte vjetore;
 - Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
 - Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar mos-pajtueshmëritë si në vijim:

- Neni 31 i Ligjit për NP-të, kërkon që brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori, zyrtarët e NP-së do të përgatisin dhe dorëzojnë në BD një raport për tremujorin e sapo përfunduar. Zyrtarët e NP-ës raportin e tremujorit të parë e kanë përgatitur me kohë, por nuk e kanë dorëzuar tek BD për miratim. Ndërsa, raportet e tremujorit të parë dhe të dytë pas këshillave tona nga auditimi i ndërmjetëm i kishte përgatitur por jo brenda afatit ligjor brenda 30 ditëve. Këto dy raporte të tremujoreve janë miratuar nga BD me datën 30.11.2017 (me vonesa gjashtë respektivisht tre muaj). Për më shumë, këto raporte nuk përmbanin të

gjitha kërkesat për raportim, respektivisht nuk i përmbanin kërkesat: Një pasqyrë të strukturës organizative të NP-së, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë tremujorit përkatës; dhe Sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsye pritet që ta rrisin performancën e NP-së.

- Po ashtu, sipas nenit 31.1 të ligjit të NP-ve kërkohet që “deri me 31 Tetor të çdo viti kalendarik, zyrtarët e secilës NP duhet të përgatisin Planin e Biznesit për vitin e ardhshëm kalendarik”. Stacioni i Autobusëve e kishte përgatitur me vonesë tre mujore, respektivisht me datën 31.01.2018.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t’i përcaktuar shkaqet për kualifikim të opinionit të auditimit dhe të merren të gjitha veprimet që çështjet të cilat kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të korrigjohen dhe të mos përsëriten.

Gjithashtu, Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë, raportet tremujore, raportet e shërbimit të faturimit dhe të kontabilitetit. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t’i dorëzohen BD-së.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Ndërmarrjen Publike Lokale. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të Stacionit të Autobusëve kanë nevojë për përmirësime thelbësore. Proceset ekzistuese të planifikimit të buxhetit nuk janë adekuate dhe nuk janë mbështetur me rishikim të buxhetit gjatë vitit. Planifikimi i buxhetit që ndërmarrja të shpenzoj më shumë sesa të realizoj të hyra rrezikon qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e ndërmarrjes. Punësimet jashtë planit të biznesit kanë shkaktuar mos pajtueshmëri me strukturën organizative dhe rritjen e shpenzimeve për paga dhe mëditje në krahasim me parashikimet në Planin e Biznesit.

Mungesa e rregullores për menaxhimin e pasurisë rrezikon që pasuritë të mos trajtohen në mënyrën e duhur dhe rrjedhimisht kjo mund të ndikojë në prezantim jo të saktë të pasurive në pasqyrat financiare.

Proceset e dobëta të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme nga qiramarrësit rrisin rrezikun që të mos paguajnë tarifat e komunalive dhe të qirasë. Kjo zvogëlon burimin e fondeve të ndërmarrjes dhe rritjen e të arkëtueshmeve dhe të borxheve të këqija. Për më shumë, dhënia me qira e aseteve të parapara për aktivitete operative të ndërmarrjes rrit rrezikun e keqpërdorimit, dëmtimit të aseteve dhe pengesë në operimin e ndërmarrjes.

Kontrollet e dobëta në dorëzimin dhe barazimin e arkës rrisin rrezikun e keqpërdorimit të parave publike dhe humbjen e besueshmërisë ndaj ndërmarrjeve publike.

Më tutje, blerja e mallrave dhe shërbimeve duke anashkaluar procedurat e prokurimit rrezikon që ndërmarrja të dëmtoj buxhetin dhe të mos arrij vlerën për paranë e shpenzuar si dhe kufizim të konkurrencës.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga BD për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin në Stacionin e Autobusëve.

3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Plani i biznesit, është një dokument përmbledhës dhe orientues i aktiviteteve të ndërmarrjes. Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin e biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2017 (në €)

Përshkrimi	Planifikimi fillestar	Plani përfundimtar	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Të hyrat nga shërbimi i Stacionit	14,142	12,442	124,689	12,098
Të hyrat parkingu	15,906	15,905	13,546	15,847
Të hyrat nga provizioni	23,992	22,762	40,972	22,366
Të hyrat nga peronizimi	576,978	553,087	518,084	541,796
Të hyrat nga shërbimi në portë	155,420	138,421	111,217	138,642
Të hyrat nga gardëroba	1,313	1,833	2,170	1,301
Të hyrat nga qiraja	157,200	157,200	160,866	152,488
Të hyrat nga komunalit e qirave	44,982	44,982	40,772	38,852
Të hyrat tjera	0	0	21	153
Gjithsej të hyrat	989,933	946,632	1,012,338	923,543
Kosto e mallit të shitur	2,400	2,400	1,262	2,121
Shpenzimet për paga	852,000	831,000	852,496	700,766
Shpenzimet administrative	11,520	22,200	47,162	23,424
Shpenzimet e rrymës, ujit dhe mbeturinave	82,050	58,800	57,798	58,570
Shpenzimet mirëmbajtjes	7,200	4,800	10,370	6,619
Shpenzimet operative	21,000	22,970	74,795	31,590
Shpenzimet tjera	9,600	0	0	94,780
Gjithsej Shpenzimet	985,770	942,170	1,043,883	917,870
Shpenzimet e zhvlerësimit	170,000	170,000	193,366	172,712
Gjithsej shpenzimet me zhvlerësim	1,155,770	1,112,170	1,237,249	1,090,582

Nga të dhënat e prezantuara më lartë, vërehet një planifikim i pa bazuar në analiza të mjaftueshme dhe të sakta për identifikimin e nevojave reale të ndërmarrjes për vitin 2017.

- Stacioni i Autobusëve kishte bërë planifikimin fillestar me tre muaj vonesë dhe më pas e kishte rishikuar Planin e Biznesit 2017-2019. Në të dy planet BD kishte planifikuar shpenzimet e ndërmarrjes më të larta se sa të hyrat e saj. Në planin e biznesit të rishikuar

ishin paraparë shpenzime më të larta se të hyrat për 165,638€ respektivisht rreth 17%. Pa ndonjë shpjegim se si do ti mbulojnë këto shpenzime;

- Ndërmarrja kishte arritur ta tejkaloj planifikimin e të hyrave nga shitjet/shërbimet për 65,706€ gjegjësisht 7%. Krahasuar me vitin paraprak të hyrat janë rritur për 88,795€ respektivisht 10%;
- Ndërmarrja kishte tejkuluar shpenzimet e përgjithshme të planifikuara për 125,079€ gjegjësisht 11%. Krahasuar me vitin paraprak shpenzimet janë rritur për 146,667€ respektivisht 13%; dhe
- Shpenzimet për paga dhe mëditje në 2017 krahasuar me vitin 2016 ishin rritur për 151,730€ respektivisht 22%.

Stacioni i Autobusëve, ndodhet në kushte ekonomiko financiare jo të favorshme për shkak të operimeve me humbje disa vite me radhë, shkaku i menaxhimit jo cilësor.

Çështja 2 – Planifikimi i dobët i të hyrave dhe shpenzimeve në planin e biznesit 2017-2019

E gjetura	<p>Ne e kemi trajtuar përmbajtjen e planit të biznesit të vitit 2017-2019 të Stacionit të Autobusëve dhe nga të dhënat e prezantuara vërehet një planifikim i dobët i aktiviteteve financiare. Planifikimi i shpenzimeve të përgjithshme të ndërmarrjes ishte më i lartë se sa të hyrat për 165,638€ respektivisht 17%.</p> <p>Përmbajtja e këtij plani për shpenzimet administrative, shpenzimet e mirëmbajtjes dhe shpenzimeve operative nuk reflekton mundësitë dhe nevojat reale të ndërmarrjes.</p> <p>Kjo për shkak të funksionimit jo të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme në përgatitjen e planit të biznesit.</p>
Rreziku	<p>Planifikimi i buxhetit që ndërmarrja të shpenzoj më shumë sesa të realizoj të hyra rrezikon qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e ndërmarrjes.</p>
Rekomandimi 2	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të bëjë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin më të lartë të shpenzimeve në raport me të hyrat e periudhës. Gjithashtu, të planifikoj nivelin e shpenzimeve brenda nivelit të të hyrave dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018.</p>

Çështja 3 – Punësime jashtë Planit të Biznesit dhe mos zbatim i parimeve themelore në punësim

E gjetura Në Planin e Biznesit 2017-2019, Stacioni i Autobusëve për realizimin e objektivave të saj kishte paraparë nevojat për praninë të 20 punonjësve në 12 pozita të ndryshme. Struktura organizative dhe organizimi i punëve janë pasqyruar në Planin e Biznesit të Ndërmarrjes të miratuar nga BD.

Stacioni i Autobusëve gjatë vitit 2017 ka punësuar 25 punonjës, pra 5 punonjës përtej planifikimit. Përveç, kësaj 8 (tetë) nga 25 të punësuar ishin për pozita të ndryshme nga ato të planifikuara me plan të biznesit.

Pozitat e plotësuara me punonjës të ri që në plan të biznesit nuk ishin parashikuar ishin:

- Punëtorë në sportelin informativ - 1 vend;
- Mirëmbajtës i hapësirave të gjelbërimit - 1 vend;
- Inkasant në sportel - 1 vend;
- Drejtor teknik - 1 vend;
- Asistente Administrative - 1 vend;
- Pastrues- 2 vende; dhe
- Vozitës- 1 vend.

Për më shumë, procesi i rekrutimit për pozitën e Drejtorit Teknik përveç që nuk ishte paraparë me Planin e Biznesit, nuk janë zbatuar parimet themelore të afirmuara në legjislacionin e punës. Gjatë kohës së zbatimit të auditimit (mars 2018), u.d i Kryeshefit Ekzekutiv ka marr vendim për ndërprerjen e kësaj marrëdhënie të punës.

Rreziku Punësimet jashtë planit të biznesit dhe mos zbatimi i parimeve themelore të punësimit mund të rrezikojnë stabilitetin financiar të kompanisë dhe mund të rezultojnë në mos pajtueshmëri me kornizën ligjore.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i biznesit respektohet dhe nevojat për punonjës dhe pozita shtesë të përfshihen në Planin e rishikuar të Biznesit në procedura të rregullta. Po ashtu, BD duhet të sigurojë mbarëvajtjen e proceseve të rekrutimit për të mundësuar zbatimin e kornizës ligjore.

3.2 Bilanci i gjendjes¹ (Pasqyra e pozitës financiare)

Ne kemi bërë auditimin e Bilancit të gjendjes, duke i testuar edhe gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

Tabela 2: Bilanci i gjendjes së Stacionit të Autobusëve më 31 dhjetor 2017 në €

Pasuritë	Viti 2017	Viti 2016	Detyrimet dhe ekuiteti	Viti 2017	Viti 2016
Paratë në bankë	94,473	243,536	Llogaritë e pagueshme tregtare	53,769	41,248
Stoqet (Materiali në depo)	1,310	1,441	Obligimet për tatime dhe kontribute	26,274	21,996
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	73,395	52,165	Llogarit tjera të pagueshme	13,176	7,880
Llogarit e arkëtueshme nga punëtorët	446	1,518	Kapitali themelues	25,000	25,000
Llogarit e arkëtueshme nga shteti dhe institucionet	52,186	37,586	Kapitali rezervë	5,226,141	5,226,141
Llogarit tjera të arkëtueshme	9,364	8,436	Humbjet e bartura	(2,235,871)	(2,068,833)
Toka	1,158,869	1,158,869	Humbja/Fitimi	(224,910)	(167,038)
Objektet ndërtimore	1,390,452	1,530,824			
Vegla dhe makineritë	103,084	52,019			
Gjithsej pasuritë	2,883,579	3,086,394	Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti	2,883,579	3,086,394

¹ SNK-t termin "Bilanc i Gjendjes" e kanë ndryshuar dhe emërtuar "Pasqyra e Pozitës Financiare", por derisa ndërmarrja e ka emërtuar bilanci i gjendjes edhe ne ju kemi referuar këtij emërtimi për të qenë konsistent me emërtimin e vet PFV-ve të cilat po i Auditohjme.

Çështja 4 – Mungesa e rregullores për menaxhimin e pasurive jo qarkulluese

- E gjetura** Sipas nenit 8.4 të Statutit të Stacionit të Autobusëve, Shoqëria duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë. Ndërmarrja nuk kishte ndonjë rregullore për menaxhimin e pasurisë e cila duhet të përshtatet me nevojat dhe kërkesat e ndërmarrjes duke u mbështetur në standardet dhe rregullat në fuqi. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit të rëndësisë së rregullores për menaxhimin e pasurive.
- Rreziku** Mungesa e rregullores për menaxhimin e pasurisë rrezikon që pasuritë të mos trajtohen në mënyrën e duhur dhe rrjedhimisht kjo mund të ndikojë në prezantim jo të saktë të pasurive në pasqyrat financiare.
- Rekomandimi 4** Kryesuesi i Bordit duhet të nxjerr një rregullore të brendshme që përcakton procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo qarkulluese, normat e zhvlerësimit, si dhe përgjegjësitë e zyrtarëve në procesin e menaxhimit të pasurive jo qarkulluese.

Çështja 5 – Dobësi në menaxhimin e Komunalive të qiramarrësve

- E gjetura** Në përputhje me rregulloren për dhënie e lokaleve afariste në shfrytëzim të përkohshëm (qiradhënie) dhe tokës, sipërfaqes për vendosjen e objekteve të përkohshme nr. 02/101 të datës 26.01.2017, Stacioni i Autobusëve i ka dhënë me qira operatorëve ekonomik disa lokale të cilat ishin në pronësi të ndërmarrjes. Të hyrat nga qiraja për 2017 nga këto lokale ishin 160,866€. Përveç pagesës së qirave, qiramarrësit e lokaleve janë të ngarkuar edhe me shpenzimet e komunalive të cilat qiramarrësit i krijojnë për ujë, energji elektrike dhe mbeturina. Këto shpenzime të komunalive për vitin 2017 ishin në vlerë 57,798€. Shpenzimet komunale fillimisht i paguan Stacioni i Autobusëve e më pas nëpërmjet një komisioni për çdo muaj i cili bënë raport për ndarjen e shpenzimeve përkatëse duke i lexuar orëmatësit e ujit dhe të energjisë elektrike.
- Nga shuma e paguar, Stacioni i Autobusëve për vitin 2017 kishte faturuar 40,772€ nga qiramarrësit të cilat më pas janë regjistruar si e hyrë e Stacionit. Kjo ka ndikuar në rritjen e të arketueshmeve nga qiramarrësit, kur kësaj ja shtojmë edhe faturimet e për qiratë vlere e tyre arrin në 201,638€ për viti 2017. Megjithatë, inkasimi i tyre bëhet me vonesë dhe me vështirësi, ku një numër i tyre inkasohet përmes procesit të përmbartimit dhe nëpërmjet gjykatës.
- Gjithashtu, Stacioni i Autobusëve nuk ka procedura të qarta për trajtimin e llogarive të arkëtueshme nga të hyrat e komunalive për qiramarrësit pasi që një pjesë e tyre janë të vjetërsuara të cilat rrezikohen të bëhen borxhe të këqija.

Rreziku Proceset e dobëta të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme nga qiramarrësit rrisin rrezikun që të mos paguajnë tarifën e komunalive dhe të qirasë. Kjo zvogëlon burimin e fondeve të ndërmarrjes dhe rritjen e të arkëtueshmeve dhe të borxheve të këqija.

Rekomandimi 5 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj politikë të qarta rreth trajtimit të komunalive të qiramarrësve dhe inkasimit të tyre. Gjithashtu të bëjë forcimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e kontratave të qiramarrësve.

Çështja 6 – Mos mbyllja e avansit të pranuar në vitin 1999

E gjetura Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, neni 353 afati i përgjithshëm i parashkrimit, thotë “Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.

Stacioni i Autobusëve në kuadër të llogarive të tjera të pagueshme në vlerë prej 13,176€, kishte edhe një avans të marr nga një person fizik në vitin 1999 (marka gjermane i konvertuar në euro) në vlerë 5,624€, si paradhënie në emër të qirasë ende pa e nënshkruar kontratën. Kontrata nuk është nënshkruar fare dhe as që është shfrytëzuar lokali, për më shumë as avansi nuk është mbyllur. Kjo për shkak të mungesës së kontrolleve dhe përgjegjësisë nga menaxhmenti që para marrjes së avansit të nënshkruaj kontratën.

Rreziku Mënyra e tillë e marrjes së avansit, dhe pa mundësia e kryerjes së shërbimit ndaj klientit apo kthimit të avansit të pranuar, për kohë mbi pesë vite, rritë rrezikun e mbivlerësimit të obligimeve.

Rekomandimi 6 Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore që të mbyll avansin dhe në të ardhmen të sigurohet që paraprakisht ka hyrë në obligime kontraktuale për të evituar marrjen e avanseve pa një marrëveshje të shkruar paraprake.

3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Stacioni i Autobusëve në Prishtinë në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2017

Të hyrat	Viti 2017	Viti 2016
Të hyrat nga shërbimi i Stacionit	124,689	12,098
Të hyrat nga parkingu	13,546	15,847
Të hyrat nga provizioni	40,972	22,366
Të hyrat nga peronizimi	518,085	541,796
Të hyrat nga shërbimet në portë	111,217	138,642
Te hyrat nga gardëroba	2,170	1,301
Të hyrat, kartelat e hyrje-daljeve	21	0
Të hyrat nga qiratë	160,866	152,488
Të hyrat tjera ²	40,772	39,005
Kosto e Mallit të Shitur/Kosto e Shërbimeve	(1,262)	(2,121)
Fitimi Bruto	1,011,076	921,422
Pagat bruto	(811,892)	(667,356)
Kontributi për sigurim pensional nga Punëdhënësi	(40,605)	(33,409)
Shpenzimet tjera administrative	(35,907)	(15,491)
Shpenzimet e Telefonit	(11,255)	(7,933)
Shpenzimet e energjisë elektrike	(57,798)	(58,570)
Shpenzimet për mirëmbajtje	(10,370)	(6,619)
Shpenzimet e tjera operative	(74,795)	(31,590)
Provizionimi dhe shlyerja e borxheve	-	(94,780)
Shpenzimet e Zhvlerësimit të vitit	(193,366)	(172,712)
Totali i shpenzimeve	(1,235,988)	(1,088,460)
Fitimi/Humbja para tatimit	(224,910)	(167,038)
Tatimi në fitim	0	0
Fitimi/Humbja e pastër	(224,912)	(167,038)

² Paraqet totalin e të hyrave nga Komunalit e qiramarrësve

Çështja 7 - Mospërputhshmëri mes kuponave fiskal të regjistruar nga arka fiskale dhe Z-raporteve të dorëzuar në arkën administrative për të hyrat e shitjes së biletave

E gjetura Kemi vërejtur mospërputhshmëri mes kuponave fiskal të regjistruar nga arka fiskale dhe Z-raporteve të dorëzuar në arkën administrative për të hyrat e shitjes së biletave. Kjo kishte ndodhur në dy arkat fiskale (me nr. GK03300556 dhe GK03300552). Në këto dy arka fiskale ishin shtypur kuponë fiskal dhe Z-Raporte për të cilët nuk ishin shitur bileta. Barazimi i arkës ishte bërë vetëm me raportin e biletave të shitura dhe me paratë e dorëzuara nga bileta shitësit, por jo edhe me deklarimin elektronik të Z-Raporteve, i cili kishte krijuar një diferencë për këto dy arka fiskale në vlerë 61,295€. Këto diferenca kanë ndodhur nga janari 2017 deri në gusht të vitit 2017. Ne kemi bërë testimet e nevojshme për periudhën janar- gusht dhe nga mostrat e testuara kemi identifikuar se janë printuar kupona fiskal dhe Z-Raporte në vlerë 5,223€, prej të cilave kanë printuar dhe shitur bileta duke i inkasuar paratë në vlerë 2,616€, ndërsa kanë shtypur kupona dhe Z-Raporte për të cilët nuk kanë shitur bileta dhe nuk kanë dorëzuar Z-Raporte në vlerë 2,608€. Gjegjësisht nga 32 Z-Raporte të arkës fiskale vetëm 15 prej tyre janë të mbuluara me bileta, ndërsa 17 Z-Raporte nuk ishin dorëzuar në Arkën Administrative pasi që për to nuk kishte shitje të biletave.

Në anën tjetër nr. i biletave në Llogarinë e biletave përputhet me parat e dorëzuar. Kjo do të thotë se për Z-raportet e pa dorëzuara nuk kanë bileta të shkruara nga bllokat dhe llogaria e biletave. Kjo kishte ndodhur për shkak të dobësive të kontrollit të brendshëm në procesin e të hyrave dhe të raportimit i cili nuk ka arrite të përcjellë numrin serik të Z-raporteve të këtyre dy arkave fiskale. Nga muaji tetor ndërmarrja ka instaluar një softuer të ri i cili është i ndërlidhur automatikisht që në momentin kur inkasanti e printon biletën lëshohet edhe kuponi fiskal për atë biletë.

Rreziku Mos barazimi i kuponëve fiskal mes biletarive me arkën administrative dhe regjistrimit të arkës fiskale rrit rrezikun e mos deklarimit të saktë të kuponëve fiskal. Gjithashtu shtypja e kuponëve fiskal për të cilët nuk është shitur bileta, ka ndikuar në deklarimin e shitjeve më të larta e cila ka krijuar obligime shtesë tatimore.

Rekomandimi 7 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme duke instaluar një mekanizëm për përcjelljen e nr. rendor të Z-raporteve dhe barazimeve të tyre me arkën fiskale si dhe barazime ditore, javore dhe mujore në mes të biletave të shitura Z-raporteve dhe arkës administrative.

Çështja 8 - Kryeshefi Ekzekutiv me vendim i shton dy të hyra të reja që nuk ishin të përfshira në rregulloren e BD

- E gjetura** Stacioni i Autobusëve ka Rregulloren për menaxhimin dhe organizimin e punëve dhe detyrave në kontabilitet dhe financa dhe pjesë e kësaj rregullore është edhe çmimorja e të gjitha shërbimeve të ndërmarrjes e cila ishte aprovuar nga BD me datën 25.01.2016.
- Megjithatë, KE kishte nxjerr vendimin nr. 02/130 me datën 18.03.2016 për shtimin e dy të hyrave nga veprimtaria e saj, njëri për automjetet e punëtorëve të qiramarrësve në vlerë 18€ në muaj për një automjet, dhe për grup taksi të cilët e shfrytëzojnë hyrjen pa limit në vlerë 255€ në muaj. Këto dy lloje të hyrave nuk ishin të përfshira në Rregulloren e miratuar nga BD. Shtimi i këtyre të hyrave duhej të bëhej nga organi kompetent në këtë rast BD e jo nga KE. Kjo ka ndodhur për shkak të keq-menaxhimit dhe mungesës së mbikëqyrjes së mjaftueshme të BD ndaj ekzekutivit.
- Rreziku** Shtimi i të hyrave nga shërbimet e veprimtarisë nga KE duke e anashkaluar BD përveç së është papajtueshmëri, rrezikon që këto të hyra të jenë të vlerësuara jo drejt.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që rregulloret që i nxjerr BD duhet të respektohen nga ekzekutivi, e në rast nevoje për plotësim ndryshime ato të propozohen nga ekzekutivi BD për miratim..

Çështja 9 - Blerja e mallrave dhe shërbimeve pa procedura të prokurimit

E gjetura

Ndërmarrjet Publike me rastin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve kanë për obligim që të respektojnë të gjitha procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Neni 16.3 i LPP thekson se: Vlera e secilës kontratë duhet parashikuar dhe procedura e prokurimit përcaktohet konform vlerës. AK nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 të këtij ligji "Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritet të jetë e barabartë me ose më e madhe se një mijë (1.000€), por më e vogël se dhjetë mijë (10.000€) konsiderohen "kontrata me vlerë të vogël, si dhe Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është më e vogël se, ose me arsye pritet që të jetë më e vogël se një mijë (1.000€) konsiderohet si "Kontratë me vlerë minimale".

Nga pagesat e testuara ne kemi vërejtur se ndërmarrja kishte bërë blerje direkt nga operatorët ekonomik duke anashkaluar procedurat e prokurimit.

Arsyet sipas ndërmarrjes ishin: sepse ato ishin me vlera të vogla. Mirëpo në analizën tonë të bazës së shpenzimeve të ndërmarrjes kemi vërejtur se kishte disa blerje të mallrave ose shërbimeve me të njëjtën kompani ku shumica prej tyre ishin bërë me para të gatshme (petty cash) me vlera nën 100€. Vlera e përgjithshme e pagesave kalon kufirin e caktuar sipas LPP-së, prandaj AK ishte dashur të përdor njërën nga llojet e kontratave të nenit të lartcekur të LPP-ës. Rastet e identifikuar po i paraqesim si në vijim:

- 14 pagesa për furnizim me bileta autobusi, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 1,280€;
- 39 pagesa për furnizim me material, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 3,297€;
- 50 pagesa për furnizim me material zyre, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 2,524€;
- 31 pagesa për furnizim me vegla pune, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 1,503€;
- 14 pagesa për furnizim me material higjienik, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 795€; dhe
- Një pagesë për Mirëmbajtje të softwerit vlera e të cilës ishte 236€.

Mangësitë e identifikuar kishin ndodhur për shkak të mos funksionimit të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme.

Rreziku Blerja e mallrave dhe shërbimeve duke anashkaluar procedurat e prokurimit rrezikon që ndërmarrja të dëmtoj buxhetin dhe të mos arrij vlerën për paratë e shpenzuar si dhe kufizim të konkurrencës.

Rekomandimi 9 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet për forcimin e kontrolleve të brendshme për të bërë një vlerësim dhe planifikim të nevojave të ndërmarrjes dhe artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së, duke shmangur ndarjen e blerjeve të njëjta në disa sosh.

Çështja 10 - Dhënia e objektit me qira në kundërshtim me rregulloren

E gjetura Kryeshefi Ekzekutiv ka dhënë me qira pyrgun nga 01.06.2017 deri me 30.06.2022 për 481€ në muaj, i cili ka qenë pjesë e aktivitetit operativ të Stacionit të Autobusëve. Pyrgu nuk ka qenë e përfshirë në rregulloren për dhënien e lokaleve afariste në shfrytëzim të përkohshëm (qiradhënie) dhe tokës, sipërfaqes për vendosjen e objekteve të përkohshme nr. 02/101 të datës 26.01.2017 të nxjerr na BD. Kjo për shkak të menaxhimit të dobët dhe të kontrolleve të brendshme jo funksionale.

Rreziku Dhënia me qira e aseteve të parapara për aktivitete operative të ndërmarrjes rrit rrezikun e keqpërdorimit, dëmtimit të aseteve dhe pengesë në operimin e ndërmarrjes.

Rekomandimi 10 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka forcuar kontrollet në ruajtjen dhe menaxhimin e pasurive të ndërmarrjes.

3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të ndërmarrjes, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

Tabela 4: Kapitali i Ndërmarrjes publike më 31.12.2017

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
KAPITALI	2,790,360	3,015,270
Kapitali themeltar	25,000	25,000
Kapitali rezervë	5,226,141	5,226,141
Fitimet/Humbjet e bartura	(2,235,871)	(2,068,833)
Fitimet/Humbja e vitit aktual	(224,910)	(167,038)

Në tabelën e mësipërme vërehet Stacioni i Autobusëve edhe këtë vit ka operuar me humbje, gjithashtu edhe në vitet paraprake kishte operuar me humbje. Kur kësaj ja shtojmë edhe një vlerë të lartë të humbjeve të akumuluar të viteve të më hershme. Kjo tregon se Stacioni i Autobusëve ka rrezik parimin e vijimësisë së veprimtarisë së sajë.

3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve afariste, financiare dhe investimit. Informatat rreth rrjedhës së parave të kompanisë janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Paratë neto nga aktivitetet operative	-45,004	83,048
Arkëtimet e parasë nga blerësit	1,012,338	923,544
Arkëtimet/pagesat tjera te parasë nga aktiviteti operativ	-35,686	74,053
Pagesa e parasë për furnitor	17,949	4,715
Pagesa e parasë për te punësuarit	-852,496	-700,766
Arkëtimet/Pagesa e parasë për tatime	4,278	-1,395
Pagesat tjera te parasë për aktivitete tjera operative	-191,387	-217,104
Paratë neto nga aktivitetet investive	-104,059	-37,445
Pagesa e parasë për blerjen e pasurive jo qarkulluese të prekshme	-104,059	-37,445
Zvogëlimi i parasë	0	0
Paratë neto nga aktivitetet financuese	0	0
Hyrjet e parasë	0	0
Daljet e parasë	0	0
Paratë neto nga aktivitetet financuese	0	0
Rritja/zvogëlimi i parasë gjatë vitit	-149,063	45,603
Paraja në fillim të vitit	243,536	197,932
Paraja në fund të vitit	94,473	243,536

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në Bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

Çështja 11 - Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese

E gjetura Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë i pasqyrave financiare duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese. Gjatë analizës së shënimeve shpjeguese janë identifikuar dobësitë si në vijim:

Stacioni i Autobusëve është i paditur në katër raste nga pretendues të ndryshëm të cilët kërkojnë nga Stacioni i Autobusëve vlerën prej 8,737€, këto raste nuk i ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Gjithashtu, nuk i ka shpalosur as rastet të cilat vet Stacioni i Autobusëve i ka paditur klientët (qiramarrësit) e vet për mos shlyerjen e obligimeve të tyre nda Stacionit të Autobusëve për tetë raste në vlerë të përbashkët 91,521€.

Rreziku Mos shpalosja e rasteve gjyqësore në shënimet shpjeguese i benë pasqyrat financiare me informacione të mangëta dhe jo në pajtim me kërkesat e standardeve të raportimit.

Rekomandimi 11 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve shënimet shpjeguese të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta për rastet në procedura gjyqësore, sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Stacionit të Autobusëve është kryer nga një kompani private e auditimit e cila kishte dhënë opinion të pa modifikuar me theksim të çështjes për shkak të mos rivlerësimit të pasurive. Ndërsa në letër menaxhment ka dhënë 5 rekomandime kryesore. Stacioni i Autobusëve nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Nga 5 rekomandimet e dhëna, 2 prej tyre janë zbatuar, 1 ishte në proces të zbatimit, dhe 2 rekomandime mbeten të pa zbatuara.

Po ashtu, në vitin 2015 ishin dhenë gjashtë rekomandime, nga këto rekomandime gjatë vitit 2017, tri ishte në proces dhe tri ishin të pa zbatuara. Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm të vitit të kaluar si mjet kyç për përmirësimin e proceseve, nuk është marrë në konsideratë nga menaxhmenti.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 12 - Zbatimi i ulët rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Ne nuk kemi vërejtur se Stacioni i Autobusëve aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve të auditorit.
- Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake rrit rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta të cilat ndërlidhen me PFV dhe me menaxhimin financiar dhe kontrollet e brendshme.
- Rekomandimi 12** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që është përgatitur një plan i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, i cili i përcakton veprimet, afatet kohore dhe stafin përgjegjës, dhe se i njëjti azhurnohet në çdo tre muaj.

5 Qeverisja

Hyrje

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Stacionit të Autobusëve, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si mungesa e një liste të rreziqeve financiare, ndikimi i ulët i auditimit të brendshëm në rritjen e efikasitetit dhe kontrolleve të brendshme, mos protokollimi i faturave, mos publikimi i rregulloreve dhe raporteve në ueb faqen e internetit dhe mos përgatitja e raportit të kënaqëshmerisë së konsumatorëve. Këto mangësi mund të kenë ndikim tek kompania në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

Qeverisja, vështruar në kuptimin e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe planifikimit strategjik, pasqyron një situatë negative. Ndërmarrja edhe pse ka përgatitur planin e biznesit, nuk i ka identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës të punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të Stacionit të Autobusëve dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kishte përgatitur Planin Strategjik për periudhën 2017/2020 dhe Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2017 dhe i kishte dorëzuar me 20.11.2016 në Komisionin e Auditimit të Ndërmarrjes për aprovim. NJAB kishte planifikuar katër auditime, të nivelit të përgjithshëm si: Investimet kapitale, Shpenzimet, Të hyrat vetanake dhe Menaxhimin e Pasurisë. Prej tyre kishte arritur të përfundoj vetëm një auditim për investime kapitale duke dhënë dy rekomandime dhe një auditim me kërkesë të Komisionit të Auditimit lidhur me rishikimin e të hyrave të tremujorit të parë të 2017. Arsyeja e mosrealizimit të planit ishte pasi që AB që nga 19/06/2017 ishte në pushim (vjetorë, mjekësor dhe të lehonisë).

Çështja 13 – Mos sigurimi i shërbimeve të auditimit të brendshëm dhe mos përgatitja e planit të veprimit për zbatim të rekomandimeve

E gjetura Auditori i Brendshëm ishte në pushim (vjetorë, mjekësor dhe të lehonisë) për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017, megjithatë Komisioni i auditimit nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim në mënyrë që të sigurojë shërbimet e auditimit të brendshëm nga komuna si aksionar apo nga ndonjëra nga ndërmarrjet publike. Kjo ka bërë që NJAB të jetë me kapacitete të kufizuara dhe me efekt të ulët në ndikimin e forcimit të kontrolleve të brendshme.

Për më shumë, menaxhmenti nuk kishte hartuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e kryer. Kjo mund të rezultojë me vazhdimin e praktikave joefektive dhe përsëritjen e mangësive të njëjta.

Rreziku Mos shfrytëzimi i shërbimeve nga auditimi i brendshëm si dhe mos hartimi i planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve financiare.

Rekomandimi 13 Kryesuesi i Bordit përmes Komisionit të auditimit në mungesë të AB-së duhet të siguroj shërbimet e auditimit të brendshëm nga aksionari si dhe të hartoj planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Gjithashtu të ndërmerr veprime për ngritjen e kapaciteteve të NJAB-it.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe manaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 14 - Nuk është bërë vlerësimi i performancës së stafit

E gjetura Është kërkesë ligjore dhe e statutit të ndërmarrjes që për çdo vit të bëhet vlerësimi i performancës së stafit. Menaxhmenti i Stacionit nuk kishte kryer vlerësimin e performances se stafit asnjëherë në vitet e mëparshme. Pas këshillave tona të dhëna në memorandumun e auditimit të ndërmjetëm, menaxhmenti kishte kryer vlerësimin e performances së stafit për 2017. Për shkak të pakënaqësisë me vlerësimet, KE i kishte anuluar të gjitha vlerësimet duke i tërhequr nga dosjet, dhe me 29.01.2018 e kishte nxjerr vendimin me numër 02/80 për vlerësimin e tërë stafit nga vetë Kryeshefi Ekzekutiv së bashku me një zyrtar të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i stafit është bërë pa i njoftuar asnjë nga punëtorët mbi performancën e tyre. Formularët mbi vlerësimin nuk janë të komentuar për përmbushjen e objektivave dhe nuk janë të nënshkruar fare nga punëtorët.

Kjo për shkak të menaxhimit të dobët dhe të mbikëqyrjes së pamjaftueshme nga BD.

Rreziku Mungesa e vlerësimit nga mbikëqyrësit e drejtpërdrejt mbi performancën e stafit dhe vlerësimi nga niveli më i lartë, përveç që krijon papajtueshmëri rrit rrezikun e mos vlerësimit të drejt dhe objektiv ndaj punonjësve.

Rekomandimi 14 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se menaxhmenti dhe punonjësit kanë kuptuar mënyrën dhe rëndësinë e sistemit të vlerësimit të performances me qëllim që të siguroj se vlerësimi bëhet në pajtueshmëri me ligjin dhe statutin për të përmirësuar performancën e ndërmarrjes. .

Çështja 15 – Mos përgatitja e raportit të kënaqshmërisë së konsumatorëve

E gjetura Sipas nenit 7 të Ligjit nr. 05/L-009 për ndryshimin e ligjit nr. 03/L-087 dhe Ligjit nr. 04/L-111 për NP, “Bordet e NP-ve një herë në vit do ta matin kënaqësinë e konsumatorëve në bazë të procedurave përkatëse përmes organizatave kredibile të pavarura. Ky raport i dorëzohet më së largu deri më 31 mars për vitin paraprak Komisionit përkatës Komunal të Aksionarëve”.

Stacioni i Autobusëve për vitin 2017 nuk ishte nxjerrë një raport të tillë i cili paraqet nivelin e kënaqësisë së konsumatorëve ndaj ofrimit të shërbimeve.

Rreziku Mos përgatitja e raportit të kënaqshmërisë së konsumatorëve është mos përmbushje e kërkesave ligjore dhe njëherit rrezikon që shërbimet e ofruara ndaj qytetarëve të mos jenë cilësore.

Rekomandimi 15 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për të përgatitur dhe publikuar raportin e kënaqshmërisë së konsumatorëve për shërbimet e ofruara.

Çështja 16 – Disa nga faturat e pranuarat ishin të pa protokoluara

E gjetura Është praktike e mirë në kontrollet e brendshme që faturat e pranuarat të protokollohen, për ti menaxhuar me mirë duke e matur kohën e pranimit deri në pagesën e saj për t’ju shmangur vonesave në afatin e përcaktuar për pagesë. Ndërmarrja me rastin e pranimit të mallrave dhe shërbimeve nga ana e furnitorëve, hyn në obligime financiare të cilat konfirmohen me faturim. Andaj ndërmarrja në momentin e pranimit të faturës duhet ta protokollojë atë dhe nga data e protokollimit të fillojë kalkulimi i afatit ligjor për kryerjen e pagesës.

Nga pagesat e testuara në kategorinë mallra dhe shërbime kemi vërejtur se në 15 raste faturat e pranuarat nuk ishin të protokolluara pasi që ato nuk ishin dërguar në arkiv për protokollim. Mos protokollimi i faturave është si pasojë e mosfunksionimit të duhur të kontrollit të brendshëm.

Rreziku Mos protokollimi i faturave rrezikon që ndërmarrja ti ekspozohet mundësive të pagesës së faturave fiktive, apo edhe të vonesave në kryerjen e obligimeve dhe si rrjedhojë të pasojnë ndëshkimet për vonesa të pagesave.

Rekomandimi 16 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se të gjitha faturat e pranuarat protokollohen në datën e pranimit të tyre, në mënyrë që të mund të maten vonesat për pagesa, të shmangen ndëshkimet për vonesa të pagesave dhe të menaxhohen me mirë obligimet e ndërmarrjes.

Çështja 17 – Mangësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rreziqeve

- E gjetura** Si pasojë e kontrolleve të dobëta menaxheriale, disa nga objektivat e planit nuk janë arritur. Blerjet pa procedura të prokurimit, vlerësimi i dobët i nevojave, mos respektimi i rregulloreve të BD nga ekzekutivi, punësime jashtë planit të biznesit dhe mbikëqyrja e pa mjaftueshme e kontrollave të brendshme nga menaxhmentit. Organizata, gjithashtu, nuk posedon ndonjë regjistër që identifikon rreziqet e ndryshme që mund t'i kërcënojnë aktivitetet e saj. Këto kanë ndodhur shkakun i llogaridhënies dhe kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme.
- Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve financiare dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore. Mungesa e një regjistri të rreziqeve potenciale, ndikon në pamundësinë e organizatës për të reaguar me kohë apo për t'i reduktuar rreziqet në nivele të pranueshme.
- Rekomandimi 17** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Bordi, gjithashtu, duhet të siguroj se është hartuar një plan i cili do të identifikoj të gjitha rreziqet e mundshme, të vlerësoj ndikim e tyre në rast se ato ndodhin, si dhe të përcaktoj masat parandaluese dhe ato të mëvonshme si përgjigje ndaj tyre.

Çështja 18 - Mos publikimi i dokumenteve në ueb faqen e internetit të kompanisë

- E gjetura** Neni 34.2 i Ligjit për ndërmarrjet publike, kërkon që një kopje e plotë dhe aktuale e të gjitha rregulloreve të NP-së do të publikohet dhe mbahet në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP-ja. Gjithashtu kërkohen të publikohen plani i biznesit, raportet tremujore, raportet vjetore dhe informata tjera të rëndësishme për publikun. Ndërsa, Stacioni i Autobusëve ende (deri në përfundim të auditimit datë 17.05.2018) nuk ka i ka publikuar asnjërën nga dokumentet e lartë përmendura. Kjo për arsye të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe përgjegjësisë së menaxhmentit.
- Rreziku** Mos publikimi i rregulloreve, planeve dhe raporteve të ndryshme të ndërmarrjes në ueb faqen e internetit krijon mos respektim të ligjit dhe mungesë të transparencës së kërkuar.
- Rekomandimi 18** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që në ueb faqen e internetit të Stacionit të Autobusëve publikohen të gjitha rregulloret, raportet dhe dokumentet që i kërkon Ligji për ndërmarrjet publike, për qëllim të transparencës ndaj publikut.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinionin të kualifikuar, opinionin të kundërt dhe mohimin të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Toka, Impiantet, Pajisjet dhe Inventari	Që të bëhet vlerësimi sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) 16 - Aktivitet Afatgjatë Materiale, Pas njohjes si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjatë materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri do të mbartet me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësim. Rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt të mjaftueshme që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në datën e bilancit.			I pa zbatuar
Llogaritë e arkëtueshme	Ne rekomandojmë që kompania të kontaktojë me klientët dhe të inkurajojë ata që të konfirmojnë llogaritë të arkëtueshme është e domosdoshme për auditorin në mënyrë që të fitojë siguri për gjendjen reale me datë 31.12.2015 si dhe për klientin i cili deklaron se nuk është e sakte gjendja sipas kartelës me datë të prerjes, të bëhet barazimi. Gjithashtu duhet të kryhet provzionimi i llogaritë të cilat mbahen në evidenca kontabël me vite të tera dhe nuk i takojnë periudhës raportuese, vitit fiskal.		Pjesërisht	
Detyrimet tjera afatshkurtra	Kompania për avanset e marra (5,999.21 dhe 1,926.70) euro, ti regjistroj si të hyra dhe ta mbyll llogarinë e avansit pasi që janë që nga viti 1999 dhe në momentin që paraqitet klienti, mund ta beje korigjimin sipas standardeve të aplikueshme. Kompania duhet të krijoj raporte bashkëpunimi dhe besimi me klientët afariste në mënyrë që klientët të bëjnë konfirmimet e gjendjes sipas kërkesës së auditorëve në mënyrë që mos të jenë bazë për klasifikim të opinionit të auditimit për shkak mungesës së konfirmimeve. Gjithashtu mos konfirmimi i gjendjeve të kërkuara nga klientët për auditorët paraqet pasiguri lidhur me paraqitjen e gjendjes reale në pasqyrat financiare.			I pa zbatuar

Pasqyra gjithëpërfshi rëse e të ardhurave	Ne rekomandojmë që për pasuritë ndërtesat te behet zhvlerësimi në bazë të SKK-3 pasi pasuria (objektet) janë ndërtuar dhe shfrytëzuar ma tepër se 20 vjet, mos te ngarkohet biznesi me shpenzimet të zhvlerësimit.		Pjesërisht	
Pagat	Duke marre për baze performancën e kompanisë (rezultatet negative në pasqyrat financiare) dhe shpenzimeve te ndodhura shihet se ka mbivlerësim të shpenzimeve te pagave dhe rekomandojmë menaxhmentin ekzekutiv dhe bordin e drejtoreve qe te ketë kujdes ne shpenzimin e buxhetit duke e orientuar ne investimet ne kompani. Me një pjesë të këtyre mjeteve do të mund të investohen në objekt dhe hapsirat që zotëron subjekti që do të ndikonte në rritjen e vlerës së të hyrave nga qiraja, nga parkingu etj.		Pjesërisht	
Parimi i vijimësisë	Kompania duhet ti kushtoj vëmendje zvogëlimit e shpenzimeve pasi qe kjo shpërndarje e shpenzimeve me përqindje të pjesëmarrjes kaq të madhe kompania mbetet larg investimeve.			I pa zbatuar
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Inventarizim i i pasurive dhe obligimeve	Ne rekomandojmë që për çdo fund vit të caktohen Komisione për regjistrime (inventarizime) gjithëpërfshirëse për pasuritë (aktivet materiale, stokun, paranë e gatshme në bankë dhe arkë, llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshmet tjera), mandej regjistrimin e obligimeve (llogaritë e pagueshme, të pagueshmet tjera, detyrimet e kushtëzuara (kontestet gjyqësore), obligimet ndaj organeve shtetërore). Po ashtu ne rekomandojmë që Komisioni i regjistrimit të bënë krahasimin e gjendjes së regjistrimit me evidencat kontabël dhe të konstaton mungesat apo tepricat eventuale dhe ti propozon Drejtimit dhe Organeve të Ngarkuara me Qeverisjen veprimet që duhet të ndërmerren.	Është zbatuar		

Toka, Impiantet, Pajisjet dhe Inventari	Që të bëhet vlerësimi sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) 16 – Aktivitet Afatgjatë Materiale, Pas njohjes si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjatë materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri do të mbartet me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt të mjaftueshme që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohet nëse do të përdorej vlera e drejtë në datën e bilancit.			I pa zbatuar
Llogaritë e Arkëtueshmë	<p>Ne rekomandojmë që të shkruhen politika dhe procedura të brendshme lidhur me konstatimin real të inkasimeve që priten nga borgji (konsumatorët) e kompanisë dhe të gjitha ato kërkesa që ka dyshim se nuk mund të realizohen, të provizionohen.</p> <p>Ne rekomandojmë gjithashtu që kompania të kontaktojë me klientët dhe të inkurajojë ata që konfirmimi i llogarive të arkëtueshme është e domosdoshme për auditorin në mënyrë që të fitojë siguri për gjendjen reale me datë 31.12.2016 si dhe për klientin i cili deklaron se nuk është e saktë gjendja sipas kartelës me datë të prerjes, të bëhet barazimi.</p>		Pjesërisht	
Llogaritë e Pagueshme	<p>Kompania për avanset e marra (5,624.21 dhe 1,734.10) euro, ti regjistroj si të hyra dhe ta mbyll llogarinë e avansit pasi që janë që nga viti 1999 dhe në momentin që paraqitet klienti, mund ta bëjë korigjimin sipas standardeve të aplikueshme.</p> <p>Kompania duhet të krijoj raporte bashkëpunimi dhe besimi me klientët afaristë në mënyrë që klientët të bëjnë konfirmimet e gjendjes sipas kërkesës së auditorëve në mënyrë që mos të jenë bazë për klasifikim të opinionit të auditimit për shkak të mungesës së konfirmimeve.</p> <p>Gjithashtu mos konfirmimi i gjendjeve të kërkuara nga klientët për auditorët paraqet pasiguri lidhur me paraqitjen e gjendjes reale në pasqyrat financiare.</p>			Nuk është zbatuar
Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave	Ne rekomandojmë që për pasuritë ndërtesat të bëhet zhvlerësimi në bazë të SKK-3 pasi që pasuria (objektet) janë ndërtuar dhe shfrytëzuar më tepër se 20 vjet, mos të ngarkohet biznesi me shpenzimet e zhvlerësimit.	Është zbatuar		

Shtojca III: Letër Konfirmimi


NPL 'Stacioni i Autobusëve' Sh.A., Prishtinë.


Nr. 02/534 Data 27.06 2018
No. Date PRISHTINË

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësajshkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të NPStacioni i Autobusëve Prishtinësh.a, për vitin 2017 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Sherif Sejdiu

Data: _____ Prishtinë,